

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr 1 i prokurimit	623-25-2296-5-2-1, 623-25-019-5-2-1
-------------------	-------------------------------------

Sa i përket tenderit për **Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Bajram Ha. Gashi B.I.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

bging2011@gmail.com

(Adresa)

**Suhareke**

(Vendi)

(Kodi postar)

**049/356164**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Bajram Gashi**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bging2011@gmail.com

(Adresa elektronike)

**21.05.2025**

(Data e parashtrimit të kërkesës)

  
(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontrate. 24.03.2025  
Hapja e ofertave. 14.04.2025  
Njoftimi mbi vendimin e AK-se 08.05.2025  
Kërkesa për Rishqyrtim 13.05.2025  
Vendimi i AK-se – Refuzimi i kërkeses 14.05.2025

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Hapja e ofertave 14.04.2025

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Operatori Ekonomik Bajram Ha. Gashi BI, me datën 13.05.2025, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim të vendimi – propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit, si rrjedhojë janë paraqitur prova, dëshmi dhe argumente për shkelje ligjore të AK – Komuna Rahovec. Pavaresisht kesaje me datën 14.05.2025, AK nxjerrë vendim dhe refuzohet kërkesen tone si të pa bazuar.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

### **Ligji nr 04/L-042, i amendamentuar.**

Neni 1 Qëllimi  
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi  
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës  
Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës  
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave  
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve  
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale  
Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrevshjeve,

### **Rregullorja me nr 001/2022, për Prokurim Publik**

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve  
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve  
Neni 97 Shkeljet e rënda

### **Ligjit nr. 06/L081, për Qasje në Dokumente Publike**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Të nderuar,

AK – Rahovec, më 08.05.2025, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe letrat standarde, me anë të së cilës jemi informuar se kompania jonë është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit në mënyrë joligjore dhe në kundërshtim me LPP është rekomanduar për dhënie të kontratës OE, pasi që kemi evidentuar shkelje të rëndë të nenit 60 paragrafi 1 i LPP, i cili përcakton kriteret për dhënie të kontratës, si dhe nenet tjera për pasojë. Marrë në konsideratë këto vendime të kundërligjshme të AK në fjalë, ne si kompani kemi shfrytëzuar të drejtën tonë që na garanton ligji, dhe brenda afatit ligjor kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e vendimit ku kemi prezantuar prova dhe dëshmi por AK – Komuna Rahovec me vendimin e datës 14.05.2025, ka refuzuar kërkesën tonë si të pa bazuar dhe tenton të procedojë tutje pavaresisht shkeljeve ligjore, prandaj në kuptim të nenit 109 të LPP-së paraqesim këtë ankesë:

### Pretendimi ankimor 1:

AK- Komuna Rahovec, na ka eliminuar padrejtësisht dhe në kundërshtim me LPP, neve si OE në këtë aktivitet të prokurimit, me arsyetimin se nuk kemi dëshmuar vlerën e kërkuar minimale për kontrata të ngjashme me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Ky arsyetim, i dhënë nga AK, nuk qëndron !

Pas publikimit të vendimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit, na është bërë e ditur edhe arsyeja e eliminimit tonë në këtë procedurë të prokurimit, siç u tha më sipër. Mirëpo, në dokumentacionin e deponuar në kohën e ofertimit në këtë proces prokurimi, ne kemi ofruar dhe listën me detajet përkatëse sipas kërkesës se përcaktuar ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate.

Ne piken 3 te kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar:

*“OE duhet te ofroj dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata te natyres se ngjashme, ne tri vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, ne vlerën prej min. 90,000.00 €”.*

Ne si OE ne oferte kemi prezantuar referenca jo të ngjashme, por te njejta edhe identike me natyren e aktivitetit te cilat tejkalojnë vlerën minimale të kërkuar.

Në listën e projekteve të realizuara dhe të dorëzuar në oferte qarte tregojne se AK – Komuna Rahovec , përkatësisht komisioni vleresues i ofertave nuk ka zbatuar drejte dispozitat ligjore nga neni 59 i LPP-se dhe tentohet te eliminohet kompania jone si e pa pergjegjeshme kunderligjeshem, perderisa deformohet gjendja faktike dhe kërkesa kualifikuese.

**Prove:** Disa nga projektet e realizuara dhe te prezantuara ne oferte:

60	Aneks kontratë për Rregullimin e oborrit të shkollës Lef Nosi në Prizren	622-22-6744-5-3-5 622-22-065-535	Komuna e Prizrenit	19.08.2022	11.10.2022	100%	3.710,00 €	isa.osmanika@rks- gov.net, 038/20044704 prokurimi.prizreni@rks- gov.net, 038/20044704
61	Rikonstruksi dhe mirëmbajtja e institucioneve edukative asistimorë-dysheime të cilat 3. Konstruksion dhe Ekipimi	618-22-13765-5-3-1	Komuna e Dibrës	05.08.2022	05.11.2022	100%	100.000,00 €	isa.osmanika@rks- gov.net, 038/20044704
73	Rregullimi i oborrit të shkollës Lef Nosi në Prizren	622-21-3967-5-2-1	Komuna e Prizrenit	22.06.2021	10.10.2024	100%	37.186,75 €	isa.osmanika@rks- gov.net, 038/20044704
109	Ndërtimi dhe rregullimi i stadiumit në shkollën Meto Bajraktari Reçan.	822-24-3348-5-2-1	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT	26.07.2024	23.12.2024	100%	118.108,10 €	isa.osmanika@rks- gov.net, 038/20044704

- **Ndërtimi dhe rregullimi i Stadiumit në Shkollën Meto Bajraktari Reçan, vlera 118,108.10EUR (projekt i njëjtë me natyren e ketije aktiviteti te prokurimit)**
- **Rregullimi i oborrit të shkollës Lef Nosi Prizren, vlera 37,186.75EUR (projekt i njëjtë me natyren e ketije aktiviteti te prokurimit)**
- **Aneks kontratë për Rregullimin e oborrit të shkollës Lef Nosi Prizren, vlera 3,710.00EUR (projekt i njëjtë me natyren e ketije aktiviteti te prokurimit)**



Vetëm me projektet e larëtcekura, tejkalohej shuma minimale prej 90,000.00EUR e cekur nga AK si kërkesë e DT në këtë proces prokurimi, për projektet e natyrës së njëjtë apo të ngjashme. Shtesë projekteve të përmendura më sipër, në të cilat ne kemi operuar si njësi e vetme ekonomike, ne kemi edhe projekte të tjera të ngjashme në natyrë me projektin në këtë aktivitet prokurimi, të cilat i kemi kryer brenda 3 vitesh duke vepruar si konsorcium me kompani të tjera si:

- Renovimi i objekteve shëndetësore- Konsorcium me Smart Eng, vlera 59,237.52EUR
- Instalimi i drenazhës dhe sanime të tjera në shkollën “Xhavit Ahmeti” dhe në IEAA tjera- Konsorcium me Smart Eng, vlera 239, 281.30EUR

113	Instalimi i drenazhës dhe sanime tjera në shkollën “Xhavit Ahmeti” dhe në IEAA tjera- Konsorcium me Smart-Eng Group	616-23-9530-5-2-1/C1351	KOMUNA E PRISHTINES	08.12.2023	30.08.2024	100%	239 281,30 €	prokurimi.prishine@e-arko.gov.nat, 0290-230 900
100	Renovimi i objekteve shëndetësore- Konsorcium me Smart-Eng Group	817-23-8874-5-2-1	Komuna Shitme	06.10.2023	20.12.2023	100%	59 237,52 €	prokurimi.Shitime@e-arko.gov.nat, 0290-

Ky pretendim yni, bazuar në dëshmitë e cekura, tregon se AK-Komuna Rahovec në këtë proces prokurimi, ka interpretuar në mënyrë të ngushtë dhe të njëanshme dëshmitë që ne kemi paraqitur lidhur me referencat e projekteve të kryera të ngjashme me procesin aktual të prokurimit, duke konsideruar vetëm një shumë prej 36,001.75EUR si valide që i plotëson kushtet e përcaktuara me DT, ndërsa siç po shihet vlera e projekteve të ngjashme në natyrë me aktivitetin e prokurimit në fjalë është mbi 300 mijë EUR, pra duke tejkalluar shumëfish pragun minimal të kërkuar me DT. Një vlerësim i tillë nga AK, publikuar sipas vendimit të tyre më 08.05.2025, përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së i cili përcakton qartë parimet bazë të konkurrencës, transparencës dhe trajtimit të barabartë, të drejtë dhe jo diskriminues të të gjithë operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, si rrjedhojë arsyetimi i eliminimit të ofertës sonë paraqet shkelje edhe të nenit 52.3 dhe 56.3 të LPP-se ku përcaktohet:

*“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.*

**Si dëshmi se pretendimi ynë qendron, gjeni si Aneks: Kontratat, paramasat dhe fotografi nga punimet e kryera në këto projekte.**

Për më detajisht të gjitha pozicionet nga kontrata Meto Bajraktari me numër rendor 1.1;1.2; 2.1; 2.2; 2.3; 2.4; 2.5; 2.6; 3.1; 3.2; 4.1; 4.2; 5.1; 5.2; 5.3; 6.1; 7.1; 8.4; 8.5; 9.1 dhe 13.1, janë me ngjashmëri identike me Aktivitetin e prokurimit në fjalë, këto të vetme tejkalojnë vlerën 94mijë eur, ndërsa aktiviteti tjetër ku kemi vepruar si konsorcium pozicionet nga paramasa në fjalë me nr 1.2; 1.3; 1.11; 1.13; 2.4; 3.1 dhe 3.1 janë me ngjashmëri identike me Aktivitetin e prokurimit në fjalë, vlera e tyre tejkallon shumën 64mijë EUR. Siç po shihet pjesa e referencave sipas kërkesave të DT është plotësuar pa asnjë mëdyshje! Por AK-Komuna Rahovec ka mbyllur sytë para këtij fakti. Dhe kjo përbën shkelje të parimeve të përkrahura nga legjislatura në bazë të së cilës qeverisen proceset nga aktiviteti i prokurimit publik.

### **Pretendimi ankimor 2:**

AK- Komuna e Rahovecit ka shkelur parimin e kërkuar nga LPP të ekonomizimit dhe efikasitetit në prokurim.

Duke rekomanduar për nënshkrim të kontratës, operator ekonomik që nuk plotësojnë kriteret sipas LPP-së.

Sipas nenit 61 të LPP, AK ka për detyrë të shpallë fituese ofertën më të ulët të përgjegjshme. Oferta jonë ka qenë plotësisht e përgjegjshme, duke përmbushur kërkesat teknike dhe administrative të përcaktuara me DT, ndërkohë që ne ofrojmë dhe çmimin më të ulët. Rrjedhimisht për zgjedhja e një OE tjetër me çmim më të lartë përbën jo vetëm shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, por edhe dëm ekonomik për buxhetin publik.

### **Pretendimi ankimor 3.**

Vlerësimi i dokumentacionit tonë është bërë në mënyrë të pasaktë dhe pa arsyetim të mjaftueshëm juridik dhe teknik.

Në vlerësimin e realizuar nga AK, nuk është dhënë asnjë justifikim i qartë për përjashtimin e kontratave të tjera dhe projekteve të ngjashme të ofruara nga ne, të cilat janë listuar e dëshmuar në ofertën tonë në këtë aktivitet të prokurimit, e po ashtu i kemi vendosur edhe më sipër në këtë kërkesë si dëshmi e ekzistencës dhe përshtatshmërisë së tyre në natyrë, kohë dhe vlerë. Kjo gjendje e krijuar nga AK, tregon për mungesë të një vlerësimi të drejtë dhe të paanshëm, mungesë të profesionalizimit apo keqinterpretim të qëllimshëm të dokumentacionit krahasuar me kërkesat e vendosura në DT.

Veprimet e tilla të AK, duhet të ndërpriten pasi që çenojnë rëndë parimet e përcaktuara në bazë të së cilave duhet të qeveriset prokurimi publik në Kosovë, siç është parimi i ligjshmërisë dhe objektivitetit në procedurën e vlerësimit të ofertave, siç është përcaktuar me nenin 6 dhe 7 të LPP-së.

### **Pretendimi ankimor 4:**

Në këtë procedurë të prokurimit publik, i vetmi OE që ka ofertuar me çmim më të ulët se ne, është GOE Eng Bau SHPK; NIKA pro-ing SHPK, Azem Sylku Thaçi, 62000 Kamenicë. Mirëpo i njëjti nuk mund të merret në konsideratë në këtë procedurë prokurimi, pasi që ka dështuar të përmbushë disa nga kërkesat thelbësore të DT, për të cilat sipas LPP-së, Rregullave dhe udhëzimeve të aplikueshme, nuk i lejohet kërkesa për sqarim apo plotësim të dokumentacionit pas dorëzimit të ofertës. Mangësitë në fjalë lidhen direkt me dokumentacionin që është thelbësor në kualifikimin e përgjegjshmërisë së ofertës dhe se një mangësi e tillë rezulton direkt me refuzimin e ofertës së tillë. Duke u bazuar në nenin 60-Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1, ofertën e OE në fjalë është e papërgjegjshme dhe e përjashtuar për procedurat e mëtejme të vlerësimit në këtë proces të prokurimit publik.

### **Mungesat e këtij OE të listuara në vijim:**

- Referencat për punë të njëjta apo të ngjashme mungojnë, nuk është plotësuar shuma (vlera e tyre prej min. 90,000.00EUR) dhe natyra e kërkuar sipas DT nuk është arritur.
- Mungon lista e numrit minimal të punëtorëve të kërkuar sipas FDT seksioni II në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional. E cila nga FDT është kërkuar të dorëzohet e nënshkruar dhe vulosur nga OE.

Një dokumentacion i tillë nuk mund të plotësohet pas dorëzimit të ofertës.

Duke konsideruar të gjitha pretendimet e mësipërme dhe duke marrë parasysh se oferta jonë është e vetmja e përgjegjshme me çmimin më të lirë, ne jemi OE që plotësojmë të gjitha kriteret e përcaktuara në këtë aktivitet prokurimi dhe bazuar në LPP, ne jemi OE që duhet të rekomandohemi për kontratë.

**Pretendimi ankimor 5:** AK- Komuna e Rahovecit, pa bazë ligjore ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE AGE group SHPK. Pasiqë OE në fjalë, i rekomanduar për kontratë përveç se nuk ofron çmim më të lirë se ne është po ashtu i papërgjegjshëm në disa pika ku dokumentacioni i ofruar nuk përmbush kërkesat e përcaktuara nga DT, përkatësisht ka mangësi esenciale në Kërkesën 5 respektivisht dëshmia 5 e DT si dhe Kërkesën 2, respektivisht dëshmia 2 e DT.

Kërkesa 5 e DT përcakton: *“Kërkesa 5: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit;”*

Dëshmia 5 përcakton: *“Dëshmia 5: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj.).*

*Vëmendje!*

*Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete origjinale ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit;”*

Ndaj kërkesave të mësipërme të DT, OE i rekomanduar për kontratë ka mangësi esenciale:

- Aneksi 9, lista e pajisjeve dhe stabilimenteve të nevojshme nuk përmban sqarime shtesë lidhur me pajisjen siç është përcaktuar. Po ashtu në listë kërkohen 2 kamionë transportues, ndërsa në dëshmitë e ofruara në këtë pikë OE i rekomanduar për kontratë ka siguruar furgon me 4 dyer dhe kamionetë me lift me 2 dyer. Lidhur me pajisjen e kërkuar “Eskavator, min. 1.5ton” OE e rekomanduar për kontratë në Aneksin 9 ka specifikuar se pajisja në fjalë është HITACHI, kurse ka dështuar të sigurojë dokumentet e pronësisë apo marrëveshjet e huazimit siç kërkohet me DT. Rrjedhimisht ka mangësi në këtë pikë. Marrëveshja e vendosur për pajisje nuk specifikon se për cilën pajisje është e lidhur e po ashtu DUD-i i vendosur për eskavator nuk përkon me atë të vendosur në listën Aneksi 9- Lista e pajisjeve, në DUD eskavatori është i markës VOLVO.



(Ky Aneks është obligativ qe të plotësohet dhe ti bashkëngjiten dëshmitë e kërkuara ne FTD)

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (copë)	Sasia që ofron ofertuesit (copë)	Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamiona regj. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj.)
1.	Kamion transportues;	2	2	Iveco Daily 07-466-EG Mercedes Benz 07-904-DA
2.	Eskavator, min. 1.5 ton;	1	1	HITACHI
3.	Pajisjet e nevojshme për montimin e rrethojave (trapan për shpuarjen e vrimave ne beton, shpuase dheut per hapjen e shputave dhe pajisje tjera përcjellëse)	1	1	BOSCH

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik:

Vula:



A	Numer i regjistrimit: Spis perestrojki: Registration number:	07-466-EG
I	Data e regjistrimit: Datum perestrojki: Date of registration:	21.03.2023
C	Të dhënat personale: Lичные данные: Personal data:	
C.2	Pronari i mjekës: Владелец автомашины: Owner of the vehicle:	
C.2.1	Mbështetësi ose emri i biznesit: Поддержка или название фирмы: Support or business name:	AGE Group SH.P.K.
C.2.2	Emri: Имя: Name:	
C.2.3	Adresa: Адрес: Address:	Ardulla Bugut p.n. Rahovec
	Data e regjistrimit të parë: Дата первой регистрации: Date of first registration:	24.07.2001
	Automjeti: Возвук: Vehicle:	
	Prodhuesi: Производитель: Maker:	IVECO
	Tipi: Тип: Type:	35C11
D3	Prodhuesi komercial: Коммерческий производитель: Commercial manufacturer:	DAILY
E	Numeri i identifikimit të automjetit: Идентификационный номер автомобиля: Vehicle identification number:	CFC3672005330200
S	Viti i prodhimit: Год выпуска: Year of production:	2001
S.1	Kapaciteti i ulësve: Емкость сидений: Seating capacity:	3
S.2	Numeri i vendosjeve për qendrat: Словесное описание: Number of standing places:	
Q	Raporti Peshë/Potential (kW/kg): Соотношение массы/мощности (кг/кВт): Power/Weight ratio (kg/kW):	
F	Pesha: Масса: Mass:	3300
F1	Pesha maksimale e ngarkesës së rrethojave: Максимальная нагрузка на раму: Maximum permissible laden mass:	840
G	Pesha e automjetit: Масса машины: Mass of the vehicle:	2680
K	Hologrami: Специальный знак: Type of approval:	
P	Moturi: Мотор: Engine:	
P1	Kapaciteti (në cm³): Емкость (л): Capacity (liters):	2800
P2	Pesha maksimale neto (në kW): Максимальная мощность (кВт): Maximum net power (kW):	78.00
P3	Lloji i karburantit: ose burimi i energjisë: Вид топлива или источник энергии: Type of fuel or power source:	Dizel - EURO 3
R	Niveli i automjetit: Безопасность: Level of safety:	X - SHUMËNGJYRËSH
2A	Niveli i konstruksionit: Конструкция: Construction:	KAMIONETË ME LIFT me 2 dyer



1	Nomeni i regjistrimit, kjoj përshkrimi, Regjistrimi numëri:	07-704-DA	D3	Produktet komerciale, Komerciale emërtimi, Commercial description:	313 COI	P	Motori, Motor, Engine:	
	Data e regjistrimit, Data e përshkrimit, Date of registration:	12.01.2022	E	Nomeni identifikues i vëllimit, Identifikuesi sipas kompanisë, Vehicle identification code:	WDB9036821R101570	P1	Kapaciteti (në cm) i, Capacity (in cm):	2149
	Të dhënat personale, Personal data:		S	Viti i prodhimit, Year of production:	2001	P2	Forca maksimale netë (në kW), Maximum net power (in kW):	95.00
2	Prodhuesi i origjinit, Business name, Owner of the vehicle:		S	Kapaciteti i ulësve, Number of seats:		P3	Çlirimi i karburantit për forcen e motorit, Type of fuel or engine:	Dizel - EURO 2
2.1	Mbikëtimi i kompanisë, Përkrahja e kompanisë, Support of business name:	AGE Group SH.P.K.	S.1	Numëri i ulësve, Number of seats:	2	R	Niveli i vlerësimit, Evaluation level:	01 - E BARDHEALOGO
2.2	Emri, Name:		S.2	Numëri i vendëve për qëndrim, Number of sleeping places:		2A	Niveli i konstruksionit, Construction:	Purgon me 4 dyer
3	Adresa, Address:	Arditë Bugej p.n. Rahovec	Q	Rregulli Për-Forcë (në kW/kg), Output Characteristic (in kW/kg):			Shënime, Remarks:	
	Data e regjistrimit të partit, Date of first registration:	04.01.2001	F	Peshë, Mass:	3500			
	Automjeti, Vehicle:		F1	Forca maksimale e vlerësimit të lehtë, Maximum admissible power:	1490			
	Prodhuesi, Make:	MERCEDES-BENZ	G	Peshë e automjetit, Mass of the vehicle:	2010			
	Tipi, Type:	903.6 KA	K	Homologimi, Type of approval:				

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR PËRKRAHJE ME MAKINERI

Kjo marrëveshje lidhe për Projektin: **Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim 623-25-2296-5-2-1 i brendshem** me date: 13.04.2025

Në mes të kompanisë "AGE group Sh.p.k" nr.unik: 810733685 adresa: Rr.Uqk-së p.n Rahovec të cilën e përfaqëson z.Tahir Bala Drejtor Ligjor, dhe

Kompanisë **EL-BAU SH.P.K** me nr.unik: 811182576 adresa: Gjilan cilën e përfaqëson z.Fatum Pireva Drejtor Ligjor.

Neni 1

Kompania **EL-BAU SH.P.K** në bazë të kësaj marrëveshjeje i jep në shfrytëzim kompanisë **AGE group Sh.p.k** makinerinë e punës për realizimin e projektit: **Titulli: Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim 623-25-2296-5-2-1 i brendshem 623-25-019-5-2-1**

Neni 2

Cmimi për furnizime dhe shërbime caktohet me aneks kontratë

Neni 3

Në rast kontestit lidhur me objektin e marrëveshjes në fjalë, kompetente është Gjykata Komunale në Prishtinë.

Neni 4

Palët e nënshkruajnë këtë marrëveshjeje në pajtim të plotë në mes tyre.

Neni 5

Kjo marrëveshjeje përpilohet në 4 (katër) kopje identike dhe nga 2 (dy) kopje i marrin palët e kësaj marrëveshjeje

Nënshkruesit e marrëveshjes:



Dokumentit Unik Doganor				ZYRA E DESTINIMIT			
2 Eksportuesi Demiri Gartenbau GmbH Lagerstrasse 14 880 Dubendorf/CH				1 DEKLARATE IM d 3042 DHEU BARDHE TERMINAL Referenca doganore R 2808 25/03/2021 Manifesti 2021 1639			
8 Marrësi / Importuesi EL-BAU SH.P.K. Gjilan Limon Staneci p.n. Gjilan				9 Personi përgjegjës financiar EL-BAU SH.P.K. Gjilan Limon Staneci p.n. Gjilan			
14 Deklaruesi A.D., Pëllumbi Dheu i Bardhë Kamenicë				15 Vendi dërgues/eksportues ZVICERRA 16 Vendi origjinës SUECIA 17 Vendi i destinacionit KOSOVA			
18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjeteve transportuese në nisje/arrijnë BU018EA AA614BU XS no				19 Kushtet e dërgesës EXW Zvicerr			
21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjeteve transportuese që kulan kufirin BU018EA AA614BU XS				22 Vahuta dhe shuma e përgjithshme CHF 7,500.00			
25 Lloji transportit 30 në kufi				26 Lloji transportit 30 Transport			
27 Vendi ngarkimit/shkarkimit 38 Lokacioni i mallrave				28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e pagesës			
31 Paketimi dhe përshkrimi i mallit Shenjat dhe numrat - Nr i kontenerit - Numri dhe lloji Shenja & nr <b>Eskavatorë i përdorur</b> Kontener Numri dhe 1 NG Lloji Pa paketim Makineritë të tjera me rrotullim të superstrukturës 360° Marka: Volvo, Tipi: EW 50, Orë pune: 3069 Ngjyra: E verdhe/hiiri, Ccm: 2216, kW: 34.8, Vili prodhimit: 2003, Nr.serik: 25658401.				32 Artikulli 1 No. 84295290 00			
44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime				33 Numri tarifor 84295290 00			
47 Llog. taksave taksat				34 Kodi origjinës a SE b 5,300.00			
				35 Pesha bruto (kg) 5,300.00			
				36 Preferenca			
				37 Procedura 4000 000 5,300.00			
				38 Pesha Neto (kg) 5,300.00			
				39 Kuota			
				40 Dokumenti paraprak/dok. përmblidhës Sht.			
				41 Njesia plotësuese PCE 1.00			
				42 Çmimi për njësi 7,500.00			
				43 M.V. 6 Kodi			
				Kodi LSH 45 Rregullimi 1,715			
				46 Vlera Statistikore 12,995.45			
48 Llogaritja e pagesës				49 Identifikimi i dorës			
50 Principali Nr				51 Zyra zyrë e tranzitit			
52 Zyra zyrë e tranzitit				53 Zyra zyrë e tranzitit			

Të gjitha këto dëshmi të sipër prezantuar tregojnë se AK – Komuna Rahovec dhe komisioni vlerësues i ofertave nuk i ka ekzaminuar dhe krahasuar ofertat në formën e duhur dhe sipas obligimit ligjor nga paragrafi 4 i nenit 59 të LPP-së, si rrjedhojë AK, mund të propozjë për dhënie të kontratës operatorin ekonomik i cili i plotëson kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit.

ING i Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;”

Ndërsa dëshmia 2, nga DT përcakton: “Dëshmia 2 • Diplomati përkatës – Kopje; Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin në këtë projekt • CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit; Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik”

Lidhur me kërkesën 2 të DT, OE i rekomanduar për kontratë ka mangësi pasi që ka mospërputhje mes të dhënave të vendosura në CV e inxhinierit të ndërtimtarisë dhe referencave të punës, referencat e lëshuara nga i njëjti OE i cili është rekomanduar për kontratë të vitit të pretenduar 2022 kurse në CV është e cekur se marrëdhënia e tyre është

themeluar në shtator 2023. Referenca tjetër e cila po ashtu është e lëshuar nga OE i rekomanduar për kontratë në këtë procedurë të prokurimit nuk përmban fare datë. Kontrata e punës përmban informacion jokredibil pasiqë në njërën anë thuhet se inxhinieri në fjalë është i punësuar me orar të plotë në këtë kompani, e nga ana tjetër orët e punës janë përcaktuar 4 orë në ditë. Rrjedhimisht nuk janë plotësuar kërkesat e përcaktuara me DT të kësaj procedure të prokurimit publik, gjë që e bën OE në fjalë të papërgjegjshëm në dokumentacion dhe po ashtu të përjashtuar edhe me nenin 60 paragrafi 1 për shkak të çmimit më të lartë.

Prandaj AK – Komuna Rahovec, komisioni vleresues i ofertave ekzaminimin krahasimin dhe vleresimin e ofertave e ka realizuar ne kundershtim me dispozitat ligjore dhe me gjendjen faktike, prandaj bazuar ne provat dhe deshmite e prezantuara si me siper OE ankues kërkon që OSHP, të autorizojë ekspert shqyrtues të paanshëm dhe i cili bazuar ne dispozitat e nenit 113 të LPP-së, i trajon të gjitha pretendimet tona ankimore në mënyrë të pavaruar dhe të paaneshme në atë mënyrë që paneli shqyrtues në procedurë pasuese të nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Të aprovohet** në tërësi ankesa e OE ankues, si e bazuar
- II. Të anulohet** njoftimi – propozimi për dhënie të kontratës si i kundërligjshëm
- III. Të obligohet** AK – Komuna Suharekë që lëndën ta kthejë në Rivlerësim dhe
- IV. Të lejohet** kthimi i mjeteve të deponuara në emër të ankesës.

Në të kundërtën ne si Operator Ekonomik, do të ndërmarrim veprime tjera ligjore ndaj zyrtarëve përgjegjës në instanca tjera përkatës pasi që eliminimi i ofertës sonë dhe rekomandimi për dhënien e kontratës është kundërligjore dhe se provat apo dëshmitë tona janë deformuar për qëllim të lidhjes së kontratës me ofertë më të lartë se sa e jona.

## 9. Dëmet materiale

*Përkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Të konsiderueshme por të njëjtat do të kalkulohen dhe do të kërkohet kompensimi i tyre.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkëngjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përfutje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përfutje me nenin 118 të LPP-se, dhe



- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

